



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA POGRADEC
KËSHILLI

Nr. 4906/13 Prot.

Pogradec, më 24. 10. 2022

VENDIM

Nr. 113 datë 21. 10. 2022

PËR DHËNIEN E NDIHMËS FINANCIARE Z. ALBERT BEGO, PËR DËMET E SHKAKTUARA NGA RËNIA E ZJARRIT NË BANESË

Në mbështetje të pikës 2 të nenit 8, të pikës 1 të nenit 29, të ligjit nr. 139/2015, “Për Veteqeverisjen Vendore”, të neneve 4, 7 dhe 41, të ligjit nr. 45/2019, datë 18.07.2019 “Për Mbrojtjen Civile” dhe të kapitullit III të V.K.M nr. 329, datë 16.05.2012 “Për kriteret dhe procedurat e dhënies së ndihmës shtetërore financiare për mbulimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësi natyrore ose fatkeqësi të tjera të shkaktuara nga veprimtaria njerëzore”, me propozim të Kryetarit të Bashkisë:

KËSHILLI BASHKIAK

V E N D O S I :

1. Miratimin e kërkesës së Bashkisë Pogradec për mbështetje financiare të shtetasit Albert Bego, për dëmtimin e banesës së tij nga rënia e zjarrit në datën 18.09.2022
2. Miratimin e dokumentacionin tekniko ligjor të hartuar nga Bashkia Pogradec.
3. Ti akordojë familjes së shtetasit Albert Bego, ndihmën emergjente në vlerën prej

451 670 lekë nga buxheti i Bashkisë Pogradec, fondi i emergjencave civile i destinuar dhe miratuar nga Këshilli i Bashkisë Pogradec për vitin 2022.

4. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Emergjencave Civile, Strehimi dhe objekteve në Bashkëpronësi, si dhe Drejtoria e Administrimit të Çështjeve Ekonomike dhe Financiare, të Bashkisë Pogradec.

5. Ky vendim hyn në fuqi menjehere pas shpalljes:

KRYETAR I KËSHILLIT

Sotiraq MANGËRI

